



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2441/ 12 prot.

Datë 13 .11.2025

V E N D I M
Nr. 1670 /2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13 .11.2025, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1541/2025, datë 28.10.2025 për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me nr. REF-51987-06-20-2025, me objekt: “Blerje materiale pastrim ambienti, për Drejtorinë e Përgjithshme të Mirëmbajtjes së Objekteve Publike”, me fond limit: 6,162,436.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 09-07-2025 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike Shkodër.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” sh.p.k me NIPT M11815028I dhe adresë Tiranë, Rruga e Kavajes, Buka SH.A, Nr.8240, Njësia Nr.6. 2.
- Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike Shkodër dhe adresë: *Lagjia Tre Heronjtë, Rruga “Marin Bicikemi” Shkodër.*
- Subjekte të Interesuara:** Operatori ekonomik “Euromega” SHPK, Nipt K91624505A, dhe adresë: *Tiranë, Prezë Fshati Ahemtaq, pranë firmës Ital Kon.*
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 28.10.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1541/2025, ku vendosi:

[...]

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” sh.p.k, për procedurën e prokurimit prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me nr. REF-51987-06-20-2025, me objekt: “Blerje materiale pastrim ambienti, për Drejtorinë e Përgjithshme të Mirëmbajtjes së Objekteve Publike”, me fond limit: 6,162,436.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 09-07-2025 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike Shkodër.

2. Autoriteti kontraktor të rivlersojë ofertën e operatorit ekonomik sipas konstatimeve të mësipërme të vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse, për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Albanian Distribution Chemicals” SHPK.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 1097 prot., datë 04.11.2025, protokolluar me tonën nr. 2441/9 prot., datë 07.11.2025, autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike Shkodër, njofton për zbatimin e vendimit nr. 1541/2025, datë 28.01.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik duke bërë .

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 1097 prot., datë 04.11.2025, protokolluar me tonën nr. 2441/9 prot., datë 07.11.2025, autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike Shkodër, njofton për zbatimin e vendimit nr. 1541/2025, datë 28.01.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik duke bërë .

II. 2. Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike Shkodër, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe nga verifikimi i raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka bërë vlerësimin në përputhje me vendimin Nr.1541/2025, datë 28.10.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me nr. REF-51987-06-20-2025, me objekt: “Blerje materiale pastrim ambienti, për Drejtorinë e Përgjithshme të Mirëmbajtjes së Objekteve Publike”, me fond limit: 6,162,436.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 09-07-2025 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike Shkodër.
 2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

